

Zyra e Marrëdhënive me Jashtë në Universitetin e Elbasanit ka nisur “Ditët e Informimit” për mobilitetet studentore me Programin Erasmus+

Zyra e Marrëdhënive me Jashtë në Universitetin e Elbasanit, ka nisur ditën e sotme "Ditët e Informimit", për mobilitetet e studentëve me programin Erasmus+, për vitin akademik 2024-2025, si dhe projektet e fituara për Ngritjen e Kapaciteteve të financuara nga Bashkimi Europian.

Pjesëmarrës ishin studentë nga programe të ndryshme të Fakultetit të Shkencave Humane dhe të Natyrës, të cilët u informuan mbi rëndësinë, mundësitë dhe modalitetet për të qenë pjesë e një eksperience të paharrueshme. Gjithashtu, personeli i Zyrës së Erasmus+, prezantoi studentët me projektet e fituara për ngritjen e kapaciteteve të financuara nga Bashkimi Europian.EU

-Projekti SHAPE- Sport, Health and the People A Western Balkan University Network (<https://shorturl.at/sBrGn>)

-Projekti LAIA- Laboratory on Artificial Intelligence in Albania and Kosovo- LAIA (<https://shorturl.at/GAcEd>)

-Projekti EduGame-Serious Games for Creativity and Social Cohesion in Teacher Education EduGame (<https://shorturl.at/7TFVB>)



